

## **RELACION**

### **PËR**

#### **PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BASHKIMI EVROPIAN-SHQIPËRI, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME CILËSINË E VËZHGUESES, NË PUNËN E AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE MËNYRËN E KËSAJ PJESËMARRJEJE NË KUADRI E RREGULLORES SË KËSHILLIT (KE) NR.168/2007**

### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.785, datë 26.12.2018, miratoi, në parim, marrëveshjen me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007.

Në mbështetje të neneve 12 e 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar projektligji i cili ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash.

Iniciativa për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, si vëzhguese, në Agjencinë Themelore të të Drejtave të Njeriut, ka filluar në vitin 2013, nëpërmjet letrës së ministrit për Punët e Jashtme, drejtuar Komisionit Evropian, i cili ka shprehur interesin për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë me statusin e vëzhguesit tek Agjencia.

Komisioni, nëpërmjet letrës së datës 20 dhjetor 2013, është shprehur se do të përcjellë propozimin për Këshillin e Stabilizim–Asociimit Bashkimi Evropian - Shqipëri. Kusht i domosdoshëm për aplikim ka qenë marrja e statusit të Shqipërisë si vend kandidat në qershor 2014, duke nxitur interesin e Komisionit për të aplikuar për statusin e vëzhguesit.

Në përputhje me një nga parimet bazë të rregullores (pra Agjencia punon në bazë të një qasjeje tematike, ndryshe nga qasje specifike për vendin), projektligji bën të mundur që Agjencia në Republikën e Shqipërisë të kryejë

detyrat e përcaktuara në kuadër të neneve 4<sup>1</sup> dhe 5, të rregullores së Këshillit (EC) nr.168/2007.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Propozimi i projektligjit nuk përfshihet në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, të miratuar me vendimin nr.764, datë 27.12.2018, të Këshillit të Ministrave.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore do të ndikojë pozitivisht në kuadër të përsheptimit të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

## **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

---

<sup>1</sup> Për të përmbushur objektivin e përcaktuar në nenin 2 dhe brenda kompetencave të tij të përcaktuara në nenin 3, Agjencia duhet:

- të mbledhë, të regjistrojë, të analizojë dhe të shpërndajë informacion dhe të dhënat relevante, objektive, të besueshme dhe të krahasueshme, duke përfshirë rezultatet nga hulumtimi dhe monitorimi i komunikuar nga shtetet anëtare, institucionet e Bashkimit, si dhe organet, zyrat dhe agjencitë e Komunitetit dhe të Bashkimit, organet kombëtare, organizatat joqeveritare, vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare dhe në veçanti nga organet kompetente të Këshillit të Evropës;
- të zhvillojë metoda dhe standarde për të përmirësuar krahasueshmërinë, objektivitetin dhe besueshmërinë e të dhënave në nivel evropian, në bashkëpunim me Komisionin dhe shtetet anëtare;
- të kryejë, të bashkëpunojë ose të inkurajojë kërkime shkencore dhe anketime, studime përgatitore dhe studime fizibiliteti, duke përfshirë, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me prioritetet dhe programin vjetor të punës, me kërkesë të Parlamentit Evropian, Këshillit ose Komisionit;
- të formulojë dhe të publikojë konkluzione dhe opinione mbi tema specifike tematike për institucionet e Bashkimit dhe shtetet anëtare gjatë zbatimit të ligjit të komunitetit, qoftë me iniciativën e vet ose me kërkesë të Parlamentit Evropian, Këshillit ose Komisionit;
- të publikojë një raport vjetor mbi çështjet e të drejtave fundamentale të mbuluara nga fushat e veprimtarisë së Agjencisë, duke theksuar gjithashtu shembuj të praktikës së mirë;
- të publikojë raporte tematike bazuar në analizat, hulumtimet dhe anketat e saj;
- të publikojë një raport vjetor mbi aktivitetet e tij dhe të zhvillojë një strategji komunikimi e të nxisë dialogun me shoqërinë civile, në mënyrë që të rrisë ndërgjegjësimin publik për të drejtat themelore dhe të shpërndajë në mënyrë aktive informacionin rreth punës së tij.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Projektligji është në përputhje me rregulloren e stafit të zyrtarëve të Bashkimit Evropian (Rregullore e Stafit) dhe kushtet e punësimit të nëpunësve të tjerë të Bashkimit Evropian (CEOS), të përcaktuara në rregulloren e Këshillit (EEC, Euratom, ECSC) nr.259/68.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore është krijuar nga rregullorja e Këshillit (EC) nr.168/2007.

Sipas nenit 2 të aktit, objektivi i Agjencisë konsiston në dhënien e asistencës dhe të ekspertizës lidhur me të drejtat themelore tek organet, zyrat dhe agjencitë e komunitetit dhe të shteteve anëtare, gjatë zbatimit të së drejtës komunitare, si dhe gjatë marrjes së masave apo përcaktimit të veprimeve brenda kompetencave të tyre, për të respektuar plotësisht të drejtat themelore.

Sipas pikës 1, të nenit 28, të aktit të Këshillit 168/2007/EC, Agjencia do të jetë e hapur për pjesëmarrjen e vendeve kandidate si vëzhguese.

Pjesëmarrja dhe modalitetet janë të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, bashkëlidhur këtij projektligji.

Pas miratimit të projektligjit në fjalë, Agjencia mund të merret në masën e nevojshme me çështje të të drejtave themelore në vendin kandidat, sipas pikës 1, të nenit 3, të rregullores së Këshillit, me synim bashkimin gradual të vendit me të drejtën komunitare.

Vendimi i Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri përcakton, gjithashtu, që Republika e Shqipërisë emëron një vëzhgues dhe zëvendësvëzhgues në bordin e menaxhimit të Agjencisë.

Këta persona duhet t'i respektojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të nenit 12, të rregullores dhe marrin pjesë në punën e bordit të menaxhimit me të njëjtat të drejta si anëtarët dhe zëvendësanëtarët e emëruar nga shtetet anëtare, por pa të drejtë vote.

Vendimi i Këshillit përfshin dispozitat në lidhje me kontributin financiar të Republikës së Shqipërisë dhe në lidhje me stafin (aneksi I), si dhe shoqërohet me një deklaratë financiare.

Neni 1 i projektligjit parashikon ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në nenin 2 të projektligjit është parashikuar që përfaqësuesi i Republikës së Shqipërisë në bordin drejtues të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore do të emërohet nga ministri i Drejtësisë, sipas parashikimeve të rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007.

Neni 3 i projektligjit parashikon hyrjen në fuqi të ligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Drejtësisë është institucioni i përshtatshëm që duhet të kryejë procedurat e anëtarësimit dhe të mbajë kontakte me Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, si institucioni lider për kapitullin 23, pjesë e të cilit janë dhe të drejtat themelore, si një nga prioritetet kyçe për integrimin në Bashkimin Evropian.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Iniciativa përkatëse ka filluar në vitin 2013, nëpërmjet letrës të ministrit për Punët e Jashtme, drejtuar Komisionit Evropian, i cili ka shprehur interesin për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë me statusin e vëzhguesit tek Agjencia. Komisioni, nëpërmjet letrës së datës 20 dhjetor 2013, është shprehur se do të përcjellë propozimin për Këshillin e Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri. Kusht i domosdoshëm për aplikim ka qenë marrja e statusit të Shqipërisë si vend kandidat në qershor 2014, duke nxitur interesin e Komisionit për të aplikuar për statusin e vëzhguesit.

Në vijim, nëpërmjet shkresës nr.20724 datë 11.12.2014, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jemi informuar se: “Sipas pikës 1, të nenit 28, të aktit të Këshillit 168/2007/EC, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore është e hapur për pjesëmarrjen e vendeve candidate si vëzhguese. Pjesëmarrja dhe modalitetet përkatëse përcaktohen me një vendim të Këshillit përkatës të Stabilizim-Asociimit, duke marrë parasysh statusin specifik të secilit vend. Vendet candidate paguajnë një kontribut financiar, që përlllogaritet si raport peshe mes popullsisë dhe produktit të brendshëm bruto në standardin e fuqisë

blerëse. Standardi i fuqisë blerëse llogaritet në bazë të të dhënave statistikore nga EUROSTAT.

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ka përllogaritur kontributin e Shqipërisë në shumën 160 000 euro në vit, me një rritje të lehtë nga viti 2019 e më pas.

Me shkresën tonë nr.2758/1 prot., datë 29.12.2014, kemi shprehur dakordësinë për anëtarësimin e Shqipërisë me statusin e vëzhguesit në Agjencinë për të Drejtat Themelore.

Në datën 8.3.2016, Komisioni ka miratuar propozimin për marrjen nga Shqipëria të statusit të vëzhguesit në Agjencinë për të Drejtat Themelore dhe në datën 19.12.2017, Këshilli ka miratuar aplikimin e vendit tonë për status vëzhguesi në Agjencinë Themelore të të Drejtave të Njeriut, pasi janë mbyllur me sukses procedurat e mbikëqyrjes parlamentare, në bazë të nenit 352, të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, së pari nga Gjermania dhe më pas nga Britania e Madhe.

Sipas procedurës, miratimi i vendimit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në agjencinë përkatëse i takon Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet shkresës me nr.5016 prot., datë 4.4.2019, na ka përcjellë letrat e Sekretariatit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit të BE-së, konkretisht të datave 9 shkurt 2018 dhe 24 janar 2019, si më poshtë vijon:

- Dakordësimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian –Shqipëri, për pjesëmarrjen e Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore; si dhe
- Depozitimi nga Komisioni Evropian te Këshilli të propozimit për marrjen e një vendimi të Këshillit të Stabilizim–Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri.

Pjesë e dokumentacionit që shoqëron projektligjin janë edhe letrat e Sekretariatit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit të BE-së, të datave 24 janar 2019 dhe 9 shkurt 2018, lidhur me dakordësinë e Këshillit të BE-së, për miratimin e vendimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Shqipërisë me cilësinë e vëzhgueses në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, si dhe të depozitimit nga Komisioni Evropian te Këshilli të propozimit për marrjen e një vendimi të Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri.

Të dyja këto dokumente janë të përkthyer dhe të certifikuara zyrtarisht në gjuhën shqipe, si dhe të përfshira në sistem.

Gjithashtu, pjesë e dokumentacionit shoqërues të projektligjit është edhe letra e pranimit nga ministri i Drejtësisë me nr.6914/3 prot., datë 25.11.2015, drejtuar Agjencisë Themelore të Drejtave të Bashkimit Evropian. Me anë të kësaj letrë, ministri i Drejtësisë ka shprehur në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë synimin për të marrë pjesë në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, në përputhje me pikën 1, të nenit 28, të rregullores së Këshillit 168/2007/KE.

Ministria e Drejtësisë, në emër të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, ka pranuar shumën e përcaktuar të kontributit financiar vjetor, e cila është 160 000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, bazuar në vlerësimin/llogaritjen e kryer nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Pagesat e detyrueshme për pjesëmarrje do të fillojnë të aplikohen për vitin e parë (2019) nga hera e parë e pjesëmarrjes në këtë Agjenci deri në fund të vitit. Për dy vitet e tjera do të aplikohet në fillim të çdo viti.

Kontributi financiar që paguhet nga Republika e Shqipërisë, në buxhetin e Bashkimit Evropian, për tri vitet e para do të jetë, si më poshtë:

Viti I: 160 000 euro (21 760 000 lekë)

Viti II: 163 000 euro (22 168 000 lekë)

Viti III: 166 000 euro (22 576 000 lekë)

Ministria e Drejtësisë ka parashikuar në PBA 2019-2021 në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, shumat përkatëse për vitet 2019, 2020 dhe 2021.

Bazuar në marrëveshjen IPA II “Mbështetje për pjesëmarrjen në programet e BE-së”, ku është parashikuar edhe kontributi i përfituesit dhe kontributi i BE-së për secilin nga programet e BE-së, 80% e shumës do të mbulohet nga IPA, nëpërmjet rimbursimit në dy vitet e ardhshme pas kryerjes së plotë të pagesës dhe pjesa tjetër prej 20% si kontribut i shtetit shqiptar.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**